



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26.2.2025

Nr: 205

Ora: 14:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMI  
POPULLOR I PENSIONISTËVE SHQIPTAR”, ME KRYETAR Z. SELAMI  
JENISHEHRI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET  
PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot më datë 26.2.2025, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesën nr. 1301 Prot., datë 25.02.2025, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, me kryetar Z. Selami Jenishehri.

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

**Baza ligjore:** Neni 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

]Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024 ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvend.

“Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, nëpërmjet Kryetarit, Z. Selami Jenishehri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 25.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, me initiale “PBPPSH”, me Kryetar Z. Selami Jenishehri, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02).

Data: 26.2.2025 Nr: 205  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, me Kryetar Z. Selami Jenishehri, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”

c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” me shkronja nistore “PBPPSH”, me adresë: Rruga "Muhamet Gjollësja", Godina "Ish Shtëpia botuese 8 Nëntori", Kt. 3, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Selami Jenishehri, me adresë: Rruga "Muhamet Gjollësja", Godina "Ish Shtëpia botuese 8 Nëntori", Kt. 3, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Artur Furriku, me adresë: Rruga "Komuna Parisit", Nd. 10, H. 20, Ap. 4, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Selami Jenishehri, me adresë: Rruga "Muhamet Gjollësja", Godina "Ish Shtëpia botuese 8 Nëntori", Kt. 3, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar” është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.01.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.

### **V E N D O S :**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar”, me kryetar Z. Selami Jenishehri, me shkronjat nistore “PBPPSH”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**